

Hardrock 1200 E

Çatitë e sheshta

PËRSHKRIMI I PRODUKTIT

Panele izoluese prej lesi guri me dy dendësi për izolim termik, akustik dhe ndaj zjarrit të çatave të sheshta të ngrohta dhe të ventiluara. Shtresa e sipërme me fortësi të lartë shënohet posaçërisht me mbishkrimin "ROCKWOOL" ose një vijë për të lehtësuar vendosjen e saktë dhe gjithmonë duhet të jetë e kthyer lart.

APLIKIMI

Panelet ROCKWOOL Hardrock 1200 E rekomandohen për izolimin e çatave të sheshta të padepërtueshme në një strukturë betoni ose fletë çeliku shumë të profiluar me kërkesa të shtuara për sa i përket rezistencës mekanike. Për shkak të strukturës së tyre me dy shtresa dhe qëndrueshmëri dimensionale, këto panele mund të instalohen në një shtresë pa shfaqjen e urave termike. Për shkak të rezistencës së tyre jashtëzakonisht të lartë mekanike, përdoren në sistemet me fiksion mekanik (membrana PVC, TPO) ose në sisteme me

ngarkesë çakëll (membrane çatie me bazë bitumi).

VETITË

- material rezistent ndaj zjarrit - reagimi ndaj zjarrit klasa A1
- panele me dy dendësi - shtresa e sipërme me densitet të lartë siguron rezistencë të lartë ndaj ngarkesave në pikë.
- veti të shkëlqyera për izolim termik - koeficienti i ulët i përçueshmërisë termike (λ) e përmirësuar edhe më shumë nga shtresa e poshtme me densitet të ulët.
- vetitë izoluese akustike.
- përshkueshmëri nga avulli.
- rezistenca ndaj ujit.
- qëndrueshmëri dimensionale.
- neutraliteti kimik.



PËRMASAT E PRODUKTIT DHE PAKETIMI

Trashësia (mm)	80	90	100	110	120	130	140	150	160
Gjatësia & Gjerësia (mm)	2000 x 1200								
m ² / palet	38,40	28,80	28,80	28,80	24,00	24,00	19,20	19,20	19,20

Dimensionet e paletës 2000 x 1200 x maksimumi 1400 mm.

PARAMETRAT TEKNIK

Vetitë	Simboli	Vlera	Standarti
Reagimi ndaj zjarrit	-	A1	HRN EN 13501-1
Përçueshmëria termike e deklaruar	λ_D	0,040 W/[mK]	HRN EN 12667
Toleranca e trashësisë	T5	- 1 mm / + 3 mm	HRN EN ISO 29466
Rezistenca ndaj shtypjes në deformim 10%.	CS(10) 80	$\sigma_{10} = 80$ kPa	HRN EN ISO 29469
Rezistenca ndaj tërheqjes pingul me faqet	TR 25	$\sigma_{m} = 25$ kPa	HRN EN 1607
Ngarkesa e pikës në deformim 5%	PL(5) 1200	Fp = 1200 N	HRN EN 12430
Përshkueshmëria ndaj avullit	MU 1	$\mu = 1$	HRN EN 12086
Absorbimi afatshkurtër i ujit	WS	≤ 1 kg/m ²	HRN EN ISO 29767
Absorbimi afatgjatë i ujit	WL(P)	≤ 3 kg/m ²	HRN EN 12087
Pika e shkrijes	T _i	> 1000°C	HRN DIN 4102
trashësia			
Çelësi i markimit	80-160 mm	MW-EN 13162-T5-CS(10)80-PL(5)1200-TR25-DS(70,-)-DS(70,90)-WS-WL(P)-MU1*	
Deklarata e Performancës (DoP)	80-160 mm	CPR-DoP-ADR-113	

*MW - lesh mineral; EN - standard evropian; Ti - toleranca e trashësisë; DS(70,90) – qëndrueshmëri dimensionale në kushte të caktuara të temperaturës dhe lagështisë relative; CS(10) - forca në shtypje; TR - qëndrueshmëria ndaj tërheqje pingul me faqet; PL(5) - ngarkesa e pikës në deformim 5 mm; WS – absorbimi afatshkurtër i ujit; WL(P) - absorbimi afatgjatë i ujit; MU1 – difuzioni i avullit të ujit (përshkueshmëria e avullit)

TRASHËSIA dhe R_D

Trashësia (mm)	80	90	100	110	120	130	140	150	160
Rezistenca Termike RD [m ² K/W]	2,00	2,25	2,50	2,75	3,00	3,25	3,50	3,75	4,00

ROCKWOOL ADRIATIC d.o.o.

Selia dhe prodhimi, Poduzetnička zona Pićan Jug 130, Zajci
HR – 52333 Potpićan
Zyra e Shitjes, Radnička cesta 80, HR - 10000 Zagreb
Tel +385 1 6197 600
www.rockwool.al

Të gjitha informacionet që përmbahen në këtë dokument kanë të bëjnë me vetitë e produktit të aplikueshme në momentin e lëshimit. Ju lutemi, gjithmonë pyesni distributorin tuaj për Skedën Teknike më të fundit, duke qenë se ne punojmë në vazhdimësi për zhvillimin e produkteve.